

KOSOVO



KOMITETI OLIMPIK
OLYMPIC COMMITTEE
Nr. 765/2020
Dt. 06.10.2020
KOSOVA

KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS
KOSOVA OLYMPIC COMMITTEE

RREGULLORE E BRENDSHME E PUNËS E BORDIT EKZEKUTIV TË KOK

Sipas autoritetit të dhënë në bazë të Statutit të Komitetit Olimpik të Kosovës, Bordi Ekzekutiv i KOK-ut, në mbledhjen e 50-të, të datës 09.07.2020 miratoi:

RREGULLOREN E PUNËS SË BORDIT EKZEKUTIV TË KOK

Neni I

1. Me këtë Rregullore parashihet puna e Bordit Ekzekutiv të Komitetit Olimpik të Kosovës dhe atë:
 - a) përgatitja, thirrja dhe mbajtja e mbledhjeve të Bordit Ekzekutiv të KOK;
 - b) udhëheqja me mbledhjet e Bordit Ekzekutiv;
 - c) mënyra e aprovimit të vendimeve, të konkluzioneve dhe të qëndrimeve të Bordit Ekzekutiv të KOK;
 - d) mënyra e emërimit të Sekretarit të Përgjithshëm të KOK;
 - e) mënyra e informimit për punën e Bordit Ekzekutiv të KOK;

Neni II

1. Mbledhjet e Bordit Ekzekutiv të KOK janë mbledhje të rregullta dhe të jashtëzakonshme.

Neni III

1. Mbledhjet e rregullta të Bordit Ekzekutiv të KOK i thërret Presidenti i KOK, ndërsa në mungesë të tij nënpresidenti i parë. Në rast të pamundësisë së nënpresidentit të parë, mbledhjet i thërret nënpresidenti i dytë, nënpresidenti i tretë dhe nënpresidenti i katërt.

Neni IV

1. Mbledhja e jashtëzakonshme e Bordit Ekzekutiv të KOK mund të thirret:
 - a) me kërkesën e Presidentit të KOK;
 - b) me kërkesën e gjysmës (50%+1) të Anëtarëve të Bordit Ekzekutiv të KOK.

Neni V

1. Mbledhja e jashtëzakonshme mund të vendoset vetëm për çështjet për të cilat është thirrur.

Neni VI

1. Mbledhjet e Bordit nuk janë publike, përveç në rastet e jashtëzakonshme kur vendoset ndryshe me shumicën e votave të anëtarëve të Bordit Ekzekutiv të KOK.

Neni VII

1. Mbledhjet e Bordit Ekzekutiv mbahen sipas nevojës, përkatësisht së paku 4 mbledhje në vit.

Neni VIII

1. Kohëzgjatja e mbledhjes së Bordit Ekzekutiv të KOK varet nga rendi i ditës së aprovuar nga ana e Bordit, mirëpo me mundësi të mos zgjatet më tepër se katër orë, përkatësisht fillon në orën 16:30 dhe përfundon në orën 20:15.

Neni IX

1. Ftesa për mbledhjen e Bordit Ekzekutiv të KOK duhet të përmbajë rendin e ditës, datën, kohën dhe vendin e mbledhjes, si dhe duhet të dërgohet tek anëtarët e Bordit Ekzekutiv më së paku shtatë (7) ditë para mbledhjes, së bashku me materialet shqyrtuese.

Neni X

1. Mbledhjen e Bordit Ekzekutiv e hap dhe e drejton Presidenti i KOK.
2. Në mungesë të Presidentit, mbledhjen e Bordit Ekzekutiv të KOK e drejton nënpresidenti i parë, në mungesë të nënpresidentit të parë, nënpresidenti i dytë, në mungesë të nënpresidentit të dytë, nënpresidenti i tretë dhe në mungesë të nënpresidentit të tretë, nënpresidenti i katërt.

Neni XI

1. Mbledhja e Bordit Ekzekutiv të KOK mbahet vetëm nëse ka kuorum, në të kundërtën mbledhja do të shtyhet dhe thirret përsëri.
2. Kuorumi i kërkuar për një mbledhje të Bordit Ekzekutiv është së paku gjysma e numrit të përgjithshëm (50%+1) të anëtarëve votues të Bordit Ekzekutiv.

Neni XII

1. Pas konstatimit se ekziston kuorumi, rendin e ditës e propozon Presidenti i KOK-ut, kurse miratimi i rendit të ditës bëhet nga anëtarët e Bordit Ekzekutiv me ngritje të dorës.
2. Secili anëtarë i Bordit Ekzekutiv ka të drejtë të propozojë plotësimin ose edhe ndryshimin e rendit të ditës, për të cilën gjë vendos Bordi Ekzekutiv i KOK.
3. Në qoftë se ka propozime për ndryshim ose plotësim të rendit të ditës, Bordi Ekzekutiv i KOK së pari vendos për këto propozime dhe pastaj aprovon rendin e ditës.

Neni XIII

1. Në mbledhjet e Bordit Ekzekutiv të KOK mbahet procesverbali. Procesverbali mbahet nga Sekretari i Përgjithshëm i KOK, ose nga Anëtari i Stafit i autorizuar nga Sekretari i Përgjithshëm.
2. Procesverbali përveç tjerash duhet të përmbajë të gjitha diskutimet dhe vendimet e Bordit Ekzekutiv të KOK.
3. Pas mbledhjes së BE duhet të hartohet Ekstrakti i Procesverbalit i cili është përmbledhje e shkurtër e diskutimeve, vendimeve dhe detyrave që dalin nga mbledhja e BE. Ekstrakti i procesverbalit miratohet në mbledhjen e radhës nga Bordi Ekzekutiv.

Neni XIV

1. Pas përfundimit të diskutimeve për secilin propozim që parashtrohet në mbledhje, votohet në Bordin Ekzekutiv të KOK.
2. Secili anëtarë i Bordit ka vetëm një votë në Bordin Ekzekutiv të KOK.

Neni XV

1. Anëtarët e Bordit Ekzekutiv të KOK që kërkojnë të diskutojnë për ndonjë temë apo pikë të caktuar, duhet të kërkojnë lejen e Presidentit të KOK ose të kryesuesit të mbledhjes.
2. Diskutuesit, përkatësishtë anëtarët e Bordit Ekzekutiv të KOK kanë të drejtë të diskutojnë vetëm për çështjen që është në rendin e ditës. Nëse largohet nga pika e rendit të ditës, Presidenti i KOK apo kryesuesi ka të drejtë t'ia ndalojë diskutimin.
3. Sekretari i Përgjithshëm ka të drejtën e fjalës për të gjitha pikat që diskutohen në mbledhje të BE, mirëpo nuk ka të drejtën e votës.
4. Diskutimi për secilin anëtar zgjatë më së shumti 3 minuta për një pikë të rendit të ditës.
5. Në rast se gjatë diskutimeve i përmendet emri ose aludohet në ndonjërin nga anëtarët e bordit apo Sekretarin, personi i apostrofuar ka të drejtë në replikë edhe 1 minutë.
6. Nuk mund të ketë më shumë se (2) dy replika për temën e njëjtë.

Neni XVI

1. Bordi Ekzekutiv i KOK mund të marrë vendime të plotfuqishme në qoftë se në mbledhje marrin pjesë më tepër se gjysma e anëtarëve të Bordit, përveç nëse me Statut dhe akte tjera kërkohet ndryshe.
2. Vendimet e Bordit të KOK janë të obligueshme për të gjithë anëtarët dhe organet e KOK.

Neni XVII

1. Vendimet në Bordin Ekzekutiv të KOK merren me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm, përveç kur një vendimmarrje rregullohet ndryshe me Statutin e KOK. Në rast të numrit të barabartë të votave “për” dhe “kundër” vendos vota e Presidentit të KOK gjegjësisht e kryesuesit.
2. Secili anëtarë i Bordit Ekzekutiv të KOK duhet të abstenojë prej votimit, për të cilën çështje ai ose ajo ka interes personal apo ekonomik, apo ka konflikt interesi.
3. Kur në mbledhje diskutohet apo vendoset për ndonjërin nga anëtarët e BE, ai/ajo anëtar/e e/i Bordit Ekzekutiv obligohet që të largohet nga mbledhja deri në momentin që merret vendimi apo përfundon diskutimi rreth asaj teme.

Neni XVIII

1. Votimi në mbledhjet e Bordit Ekzekutiv të KOK bëhet me vota të hapura. Në qoftë se çështja është e rëndësishë së veçantë dhe Bordi mendon se votimi duhet të bëhet me vota të fshehta, atëherë veprohet sipas vendimit të shumicës.

Neni XIX

1. Sekretari i Përgjithshëm i KOK propozohet nga Presidenti, ndërsa emërohet nga Bordi Ekzekutiv i KOK.
2. Sekretari i Përgjithshëm me KOK themelon marrëdhënie pune me orar të plotë, me kontratë pune.
3. Në qoftë se anëtarët e Bordit të KOK nuk pajtohen me propozimin e Presidentit, atëherë Presidenti ka të drejtë të propozojë një kandidat të cilin mendon se Bordi Ekzekutiv do ta votojë me shumicë të votave.
4. Votimi për emërimin e Sekretarit të Përgjithshëm bëhet me vota të hapura, përveç nëse Bordi Ekzekutiv i KOK nuk vendos ndryshe.

Neni XX

1. Bordi Ekzekutiv i KOK mund të formojë grupe punuese (Komisione) të përhershme dhe të përkohshme, nëse është e nevojshme.
2. Puna e Komisioneve të përhershme dhe atyre të përkohshme të KOK, rregullohet me rregullore të veçantë.

Neni XXI


1. Për punën e vet, Bordi Ekzekutiv i KOK rregullisht informon opinionin publik, e në veçanti anëtarët e saj, përkatësisht raporton në Asamblenë e Përgjithshme të KOK. Informimi bëhet ndërmjet mjeteve të informimit, raporteve vjetore, kuvendeve të punës etj.

Neni XXII

1. Kjo rregullore konsiderohet e aprovuar nëse për të votojnë dy të tretat (2/3) e anëtarëve të Bordit Ekzekutiv të KOK, që marrin pjesë në mbledhje.
2. Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj Rregullore bëhet në të njëjtën mënyrë sikurse edhe aprovimi i saj.

Neni XXIII

1. Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e aprovimit të saj nga Bordi Ekzekutiv i KOK, të cilën e nënshkruan presidenti i KOK.



Besim Hasani,

President